



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



PERFORMANCA E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSVE

NË KOSOVË – 2022 H1

Shtator, 2022

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	3
2. PASQYRA E PËRGJITHSHME E SEKTORIT TË UJIT.....	4
3. PERFORMANCA RELATIVE E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSVE.....	6
4. KONKLUZIONE TË PËRGJITHËSHME.....	20
SHTOJCA.....	21

1. HYRJE

Në këtë raport është paraqitur performanca e kompanive publike të cilat ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura për periudhën 2022 H1 (gjysma e parë e vitit 2022) krahasuar me vitin 2021, në disa prej treguesve kyç të performancës, të cilët më së miri pasqyrojnë aspektet menaxhimit të punës në KRU.

Ky raport paraqet performancën relative të kompanive të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura në nivel të sektorit si dhe performancën relative individuale për secilën kompani.

Raporti është përgatitur duke u bazuar në të dhënat e raportuara nga kompanitë e ujit në pajtim me obligimet e tyre raportuese. Po ashtu duhet të kihet parasysh së të dhënat e vitit 2021 janë të audituar, ndërsa të dhënat për periudhën 2022 H1 janë të dhëna të raportuara dhe të pa audituara.

Ky raport preliminar ka për qëllim që zyrtarëve përgjegjës të KRU-ve dhe palëve të tjera të interesit të involvuar në sektorin e ujit të ju ofrojë një analizë të trendëve të zhvillimit për disa prej **Treguesve Kyç të Performancës**, për periudhën e parë 6 mujore të vitit 2022.

Treguesi i kualitetit të ujit nuk është shqyrtuar, për shkakun e mungesës së të dhënave-raporteve nga IKSHPK. Në lidhje me këtë tregues të performancës, që është edhe standard i shërbimit, ARRU është konsultuar dhe dakorduar, që tash e tutje për kualitetin e ujit KRU-të të raportojnë drejtpërdrejt tek ARRU sipas një formulari që është përgatitur nga ARRU dhe që është ndarë me të gjitha KRU-të.

2. PASQYRA E PËRGJITHSHME E SEKTORIT TË UJIT

Sektori i ujit në Kosovë për disa tregues ka treguar një përmirësim të lehtë në periudhën 2022 H1 në drejtim të përmbushjes së caqeve të aprovuara përmes procesit tarifor 2022-2024. Megjithatë, tek një numër treguesish të tjerë ka ngecje. Në përgjithësi KRU-të ende nuk kanë arritur nivel të qëndrueshëm të treguesve kryesor të performancës.

Në vazhdim të këtij raporti të performancës janë përmbledhur disa nga treguesit kryesor të performancës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2022 për sektorin si tërësi dhe për secilën KRU veçmas, të njëjtit tregues janë krahasuar me vitin paraprak (2021). Të dhënat më të detajuara të treguesve operativ dhe financiar janë përmbledhur në Shtojcën 1 të këtij raporti.

Në tabelën 1. është paraqitur performanca e sektorit të shërbimeve të ujësjellësit për treguesit vijues të performancës, për periudhën gjashtëmujore 2022 (2022 H1) të krahasuar me vitin 2021.

Tabela 1. Performanca relative në nivel të sektorit për KRU e Ujit

Treguesit	2021	2022 H1
Prodhimi i ujit (l/b/d)	301	296
Shitja e ujit (l/b/d)	135	136
Uji i pa-faturuar (%)	55	54
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%) ¹	98	98
Shkalla e arkëtimit (%)	96	84
Norma e mbulimit të punës	1.31	1.14
Kostoja totale për njësi (€/m ³ të ujit të prodhuar) ²	0.16	0.17
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	4.84	4.67
Ankesat për ('000 kons)	63	11

Në nivel sektori prodhimi i ujit është rreth 296 litër për banor në ditë [l/b/d], që është normë e lartë në raport me normën standarde të nevojave ditore për një banor, ndërsa tek shitjet vlera është shume e ultë vetëm 136 [l/b/d]. Gjatë periudhës 2022 H1 megjithëse vërehet një përmirësim i lehtë krahasuar me vitin paraprak 2021, por që nuk është përmirësim i kënaqshëm.

Uji i pa-faturuar (UPF) i shprehur si përqindje ka shënuar përmirësim të vogël për 1% gjatë periudhës gjashtëmujore 2022 H1 krahasuar me vitin paraprak 2021. Uji i pa-faturuar edhe më tej vazhdon të jetë shumë i lartë pa përjashtim tek të gjitha KRU-të, dhe është më e lartë se sa standardet dhe praktikrat e mira ndërkombëtare për këtë tregues (<20 %).

¹ Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës kalkulohet duke marrë parasysh të dhënat e raportuara nga KRU-të për konsumatorët shtëpiak me matje dhe pa matje si mesatare e vitit aktual dhe vitit paraprak në këtë rast viti paraprak 2021 dhe gjashtëmujori i parë i vitit 2022 H1.

² Ky tregues merr për bazë të gjitha shpenzimet operative për shërbimet e ujësjellësit (shpenzimet e ujit të prodhuar/trajtuar, shpenzimet e ujit të distribuuar, dhe shpenzimet e aktiviteteve biznesore) në raport me sasinë e ujit të prodhuar.

Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës, gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore nuk ka shënuar trend përmirësimi në raport me vitin paraprak; afërsisht 2% e konsumatorëve nuk janë pajisur ende me ujëmatës. ARRU do të inspektojë të dhënat e raportuara nga KRU-të për sa i përket mbulimit me ujëmatës të konsumatorëve, pasi faturimi sipas matjes është standard i shërbimit.

Shkalla e arkëtimit ka shënuar ulje ndjeshme për 12% gjatë periudhës 2022 H1, kjo ulje i atribuohet më së shumti zvogëlimit të shkallës së arkëtimit tek konsumatorët institucional dhe pjesërisht tek konsumatorët e amvisërisë. Zakonisht konsumatorët institucional pagesën e faturave e kryejnë në pjesën e dytë të vitit. Një tjetër arsye e zvogëlimit të shkallës së arkëtimit mund të jetë përqendrimi i gjendjes sociale të konsumatorëve shtëpiak për shkak të rritjes së kostos së jetesës, megjithëse fatura e ujit krahasuar me pagën mesatare në Kosovë nuk e kalon përqindjen prej 2.54%.

Norma e mbulimit të punës po ashtu ka shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak nga 1.31 sa ishte në vitin 2021 në 1.14 gjatë periudhës 2022 H1, e cila kryesisht ka ndodhur për shkak të rritjes së shpenzimeve operative totale dhe rënies së arkëtimit të ardhurave të faturuara duke përfshirë edhe subvencionimin.

Kostoja e përgjithshme për m³ të ujit të prodhuar ka shënuar rritje nga 0.16 €/m³ sa ishte në vitin 2021 në 0.17 €/m³ gjatë periudhës 2022 H1, rezultat i të cilës është zvogëlimi i volumit të ujit të prodhuar në m³ dhe rritja e shpenzimeve operative për shërbimet e ujit (kryesisht si rezultat i rritjes së kostos së kemikalieve dhe materialeve të tjera të ndërlidhura me përpunimin e ujit).

Efikasiteti i stafit gjatë periudhës 2022 H1 ka treguar trend pozitiv krahasuar me vitin 2021, trend i cili është ndikuar pjesërisht nga rritja e numrit të konsumatorëve (gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 14,472 konsumatorët të rinj nga të gjitha KRU-të) dhe nga rënia e lehtë e numrit të punëtorëve. Niveli i arritur i efikasitetit të stafit me 4.67 punëtor për 1,000 konsumatorë për shërbime të ujit dhe kanalizimit është brenda nivelit të standardit nën 5 punonjës për 1,000 konsumatorë.

Për periudhën 2022 H1 mesatarja ankesave të adresuara për çdo 1,000 konsumatorë është 11, tregues ky i cili pasqyron nivelin e shërbimeve të ofruar nga kompanitë e ujit dhe është dukshëm më i ulët se sa në vitin 2021. Numri më i madh i ankesave të parashtruara nga ana e konsumatorëve janë sa i përket aspektit operativ të shërbimit kurse numër më i vogël janë të natyrës komerciale. Numri i ankesave të raportuara nga KRU-të duhet të verifikohet nga ARRU.

3. PERFORMANCA RELATIVE E KOMPANIVE RAJONALE TË UJËSJELLËSVE

Kjo pjesë e raportit pasqyron performancën relative individuale të kompanive për përudhen e gjashtëmujorit të parë (H1) të vitit 2022, e të dhënat krahasuar me vitin 2021.

KRU Prishtina sh.a.

Në tabelën 2 është paraqitur performanca e KRU Prishtina sh.a. në disa prej treguesve më reprezentativ.

Tabela 2. Performanca relative e KRU Prishtina sh.a.

Treguesit	2021	2022 H1
Prodhimi i ujit (l/b/d)	348	343
Shitja e ujit (l/b/d)	146	150
Uji i pa-faturuar (%)	58	56
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	99	99
Shkalla e arkëtimit (%)	91	82
Norma e mbulimit të punës	1.28	1.20
Kostoja totale për njësi (€/m3 të ujit të prodhuar)	0.18	0.19
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	3.62	3.43
Ankesat për ('000 kons)	61	0.8

Gjatë periudhës 2022 H1, KRU Prishtina ka prodhuar 343 [l/b/d] e cila vlerë nëse krahasohet me vitin 2021, ka një ulje të vogël, por ende ka mbetur mjaftë e lartë. Edhe te treguesi tjetër i shitjes së ujit (faturimi - l/b/d) ka një përmirësim të vogël. Megjithëse, as gjysma e ujit të prodhuar nuk shitet.

Uji e pa-faturuar për KRU Prishtina ka shënuar përmirësim të vogël, nga 58% sa ishte gjatë vitit 2021 ka rënë në 56% gjatë periudhës 2022 H1. Zvogëlimi i prodhimit dhe rritja shitjes së ujit kanë reflektuar menjëherë tek përmirësimi për 2% i nivelit të UPF-së gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore 2022 H1.

Gjatë periudhës 2022 H1, proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës ka mbetur i njëjtë me vitin paraprak 2021 me 99%. Gjatë verifikimeve të mëhershme, tek KRU Prishtina ka një numër të konsiderueshëm të konsumatorëve që nuk janë pajisur me ujëmatës, të cilët duhet të pajisen me ujëmatës sa më shpejtë.

Në 2022 H1 krahasuar me vitin 2021 shkalla e arkëtimit ka shënuar rënie për 9% dhe është tejet shqetësuese. Në këtë ulje të arkëtimit, ka ndikuar pjesërisht rritja volumetrike e faturimit për konsumatorë, por edhe përkeqësimi i mirëqenies sociale të konsumatorëve.

Norma e mbulimit të punës gjithashtu ka shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak nga 1.28 sa ishte në vitin 2021 në 1.20 në periudhën 2022 H1, shkak i të cilës është rënia e arkëtimit të ardhurave dhe rritja e lehtë e shpenzimeve operative totale. Megjithëse KRU Prishtina ka treguar trend negativ në këtë tregues për gjashtëmujorin e parë të vitit 2022, prapë ka qenë në

pozitë të mirë financiare që të mbulojë shpenzimet operative dhe të gjenerojë burime financiare për realizimin e investimeve kapitale.

Kostoja e përgjithshme për m³ të ujit të prodhuar për KRU Prishtina për periudhën 2022 H1 krahasuar me vitin 2021 ka treguar një rritje të lehtë nga 0.18 Euro/m³ në 0.19 euro/m³.

Efikasiteti i stafit është treguesi tek i cili KRU Prishtina ka treguar trend pozitiv në raport me vitin 2021 me një rënie prej 5%, që ishte kryesisht si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve dhe zvogëlimit të numrit të punëtorëve.

Është shënuar një ulje drastike e numrit të ankesave për 1,000 konsumatorë; ARRU të analizojë nëse problemi qëndron te mos raportimi i saktë i KRU Prishtina për këtë tregues, apo ka një zvogëlim të vërtetë të ankesave të konsumatorëve. Në anën tjetër ankesat që vijnë në ARRU nga konsumatorët prej zonës së shërbimit që mbulon KRU Prishtina ka një rritës.

Arritjet e shënuara:

- Janë instaluar mbi 3,000 ujëmatës të rinj, vërehet një trend i mirë i pajisjes së konsumatorëve me ujëmatës.
- Zvogëlim i UPF; KRU Prishtina inkurajohet të vazhdojë me këtë trend të adresimit të problemit të UPF. Të optimalizohet sa më mirë prodhimi i ujit dhe të rritet faturimi i ujit.
- Efikasiteti i stafit është përmirësuar në periudhën H1-2022, është rritur numri i konsumatorëve për 4,860, e në anën tjetër ka pasur edhe rënie të lehtë të numrit të punëtorëve.

Sfidat:

- Përmirësimi i efikasitetit operacional, me ç'rast rritja e prodhimit të ujit të ndodhë vetëm nëse ka rritje të kërkesës për ujë, rritja e numrit të konsumatorëve (shtrirja e mbulueshmërisë me shërbime) dhe përmirësimin e vazhdimësisë së furnizimit.
- KRU Prishtina duhet angazhuar edhe me tutje në zvogëlimin e UPF, duke marrë masa dhe aktivitete më dinamike për zvogëlimin e rrjedhjeve si dhe adresimin e humbjeve komerciale, duke instaluar ujëmatës për secilin konsumatorë.
- Përmirësimi i shkallës së arkëtimit është me shumë rëndësi, pasi KRU Prishtina ka pasur një ulje të theksuar të arkëtimit gjatë 2022 – H1.
- Optimalizimi i kostos relativisht të larta për ofrimin e shërbimeve, që kryesisht vijnë nga rritja e shpenzimeve operative (shpenzimet e personelit dhe energjia).

KRU Hidroregjioni Jugor, sh.a.

Në tabelën 3 është paraqitur performanca e KRU Hidroregjioni Jugor sh.a. për disa prej treguesve më reprezentativ.

Tabela 3. Performanca relative e KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.

Treguesit	2021	2022H1
Prodhimi i ujit (l/b/d)	212	200
Shitja e ujit (l/b/d)	97	92
Uji i pa-faturuar (%)	54	54
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	100	100
Shkalla e arkëtimit (%)	100	92
Norma e mbulimit të punës	1.32	1.18
Kostoja totale për njësi (€/m ³ /prodhuar)	0.18	0.17
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.14	5.86
Ankesat për ('000 kons)	62	30

Prodhimi i ujit i shprehur në njësinë [l/b/d] tek KRU Hidroregjioni Jugor gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore është i lartë me 200 [l/b/d], përderisa shitjet janë me pak se gjysma e prodhimit me vetëm 92 [l/b/d]. Përndryshe nëse bëjmë krahasimin mes vitit paraprak 2021 dhe periudhës 2022 H1 kemi një ulje të prodhimit – që është pozitive, por ajo që shqetëson është zvogëlimi i volumit të shitjes së ujit për banorë.

Gjate periudhës 2022 H1 uji pa-faturuar nuk ka shënuar ndonjë përmirësim ne raport me vitin paraprak 2021, vlera mbetet e njëjta 54%.

Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës te KRU Hidroregjioni Jugor arrin nivelin prej 100%, që do të thotë se të gjithë konsumatorët shtëpiak janë pajisur me ujëmatës. Ky tregues duhet të verifikohet nëse reflekton realitetin dhe nëse ujëmatësit e instaluar janë funksional.

KRU Hidroregjioni Jugor në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022 ka shënuar përkeqësim në mbledhjen e të hyrave të faturuara. Norma e arkëtimit ka rënë në nivelin prej 92%, rënia është për 8% krahasuar me vitin 2021. Arkëtimi është përkeqësuar kryesisht tek kategoria e konsumatorëve shtëpiak dhe institucional.

Norma e mbulimit të punës po ashtu ka treguar regres në raport me vitin paraprak, rezultat i të cilës është rritja e lehtë e shpenzimeve operative totale për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura dhe rënia e të ardhurave të arkëtuara.

Në periudhën 2022 H1 krahasuar me vitin 2021 kostoja e përgjithshme m³ të ujit të prodhuar kanë treguar përmirësim, rezultat i të cilës është zvogëlimi i shpenzimeve për shërbimet e ujit për 14% përkundër zvogëlimit të ujit të prodhuar.

Efikasiteti i stafit po ashtu ka shënuar progres gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve dhe zvogëlimit të numrit të punëtoreve.

Për sa i përket ankesave, sipas të dhënave të raportuara duket që numri i ankesave është përgjysmuar në gjashtë mujorin e parë të vitit 2022 H1 krahasuar me vitin 2021.

Arritjet:

- Mbulueshmëria e plotë e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës, ky tregues duhet të verifikohet.
- Trendi zvogëlues i kostos së përgjithshme për njësi të ujit të prodhuar, si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve të përpunimit të ujit.
- Efikasiteti i stafit është përmirësuar si rezultat i shtimit të numrit të konsumatorëve.

Sfidat:

- Zvogëlimi i humbjeve të ujit dhe angazhimi për ti adresuar si humbjet fizike (përmirësimi të infrastrukturës së ujit) po ashtu edhe humbjet komerciale përmes identifikimit të kyçjeve ilegale, saktësisë së leximit dhe ujëmatëseve.
- Përmirësimi i efikasitetit të arkëtimit, duhet të arkëtohen konsumatorët shtëpiak dhe ata institucional.

KRU Hidrodrini sh.a.

Në tabelën 4. është paraqitur performanca e KRU Hidrodrini sh.a. për disa prej treguesve më reprezentativ.

Tabela 4. Performanca relative e KRU Hidrodrini sh.a.

Treguesit	2021	2022 H1
Prodhimi i ujit (l/b/d)	346	343
Shitja e ujit (l/b/d)	144	146
Uji i pa-faturuar (%)	58	57
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	100	98
Shkalla e arkëtimit (%)	129	78
Norma e mbulimit të punës	1.77	1.06
Kostoja totale për njësi (€/m ³ /prodhuar)	0.10	0.11
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	4.32	4.11
Ankesat për ('000 kons)	45	43

Gjatë periudhës 2022 H1 prodhimi i ujit shprehur në njësinë [l/b/d] është i lartë dhe arrin 343 [l/b/d]. Nga kjo sasi vetëm 146 [l/b/d] iu është faturuar konsumatorëve. Shitjet e ujit janë shumë pak më të larta krahasuar me vitin 2021. Megjithëse ka një përmirësim shumë të lehtë krahasuar me vitin 2021, pra ulje shumë e vogël e prodhimit dhe rritje të shitjes, prapë se prapë këto të dhëna janë brengosëse edhe përkundër faktit që kostoja e prodhimit të ujit në KRU Hidrodrini është relativisht e ulët.

Gjatë periudhës gjashtëmujore 2022 H1, proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës qëndron në pozitën prej 98%. Fokusi i KRU duhet të jetë në rritjen e mbulueshmërisë së konsumatorëve me ujëmatës funksional.

Uji i pa-faturuar gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore 2022 H1 ka pësuar një zvogëlim për 1% në raport me vitin paraprak 2021, që është rezultat i uljes së prodhimit dhe rritjes së lehtë të shitjes.

Gjatë periudhës 2022 H1 shkalla e arkëtimit ka shënuar rënie më të lartë nga të gjitha KRU-të krahasuar me vitin 2021. Përqindja e arkëtimit për 2022 H1 është vetëm 78% (ulje prej 51%) Duhet potencuar se arkëtimi në vitin 2021 ka qenë 129% - që i atribuohet arkëtimit të borxheve të vjetra. KRU Hidrodrini duhet të analizojë shkaqet e rënies së arkëtimit dhe të fokusohet në përmirësimin e këtij treguesi në periudhën e mbetur të vitit.

Norma e mbulimit të punës ka rënë prej 1.77 në vitin 2021 në 1.06 në 2022 H1; kjo ulje ka ardhur si pasojë e uljes së shkallës së arkëtimit. KRU Hidrodrini ka qenë në gjendje të mirë financiare në vitin 2021, mund ti mbulojë shpenzimet operative, me mundësinë gjithashtu që të bëjë edhe investime kapitale.

Kostoja e përgjithshme për m³ të ujit të prodhuar ka shënuar rritje nga 0.10 €/m³ sa ishte në vitin 2021 në 0.11€/m³ gjatë periudhës 2022 H1, rezultat i të cilës ishte zvogëlimi i ujit të prodhuar në m³ dhe rritja e shpenzimeve operative për shërbimet e ujit.

Efikasiteti i stafit ka treguar trend pozitiv për periudhën 2022 H1, rezultat i këtij trendi pozitiv, ishte rritja e numrit të konsumatorëve dhe mbajtja në nivel të njëjtë e numrit të punëtorëve. KRU Hidrodrini ka zgjeruar bazën e vet të konsumatorëve me mbi 2,700 konsumatorë të rinj.

Numri i ankesave të konsumatorëve gjatë 2022 H1 është pothuaj i njëjtë me vitin 2021.

Arritjet:

- Ka një përmirësim të lehtë për sa i përket ujit të prodhuar dhe të faturuar (l/b/d) krahasuar me vitin 2021.
- Si rezultat i zvogëlimit të prodhimit dhe rritjes së faturimit, uji i pa faturuar ka shënuar progres për 1% ne raport me vitin paraprak 2021, megjithëse niveli i UPF për KRU Hidrodrini mbetet më i lartë në mesin e të gjitha KRU-ve.
- Efikasiteti i stafit është përmirësuar edhe përkundër futjes në operim të impiantit të përpunimit të ujërave të ndotur.

Sfidat:

- Uji i pa-faturuar ende mbetet në nivel të lartë (57%) kompania ende duhet që të zvogëlojë prodhimin e ujit dhe ti rris sasinë e shitjes dhe po ashtu kompania duhet të ndër marrë edhe masa të tjera shtesë për reduktimin e humbjeve fizike dhe atyre komerciale.
- Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës ka shënuar regres gjatë periudhës 2022 H1 (98%) ne raport me vitin paraprak 2021 (100%). KRU Hidrodrini duhet të instalojë ujëmatës për të gjithë konsumatorët dhe faturimi të bëhet sipas matjes.

KRU Mitrovica sh.a.

Në tabelën 5. është paraqitur performanca e KRU Mitrovica sh.a. për disa prej treguesve më reprezentativ.

Tabela 5. Performanca relative e KRU 'Mitrovica', sh.a.

Treguesit	2021	2022 H1
Prodhimi i ujit (l/b/d)	472	465
Shitja e ujit (l/b/d)	209	228
Uji i pa-faturuar (%)	55	51
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	90	91
Shkalla e arkëtimit (%)	74	69
Norma e mbulimit të punës	1.08	0.86
Kostoja totale për njësi (€/m ³ /prodhuar)	0.11	0.12
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.92	5.84
Ankesat për ('000 kons)	224	1.3

Prodhimi i ujit [l/b/d] në KRU Mitrovica edhe gjatë periudhës 2022 H1 është shumë i lartë. Vlera e prodhimit është 465 [l/b/d] që është prodhimi volumetrik më i larti nga të gjitha KRU-të për kokë banori. Brengosë fakti se as gjysma e ujit të prodhuar nuk faturohet (nuk shitet) edhe pse është shënuar një rritje e vogël tek shitjet; nga 209 [l/b/d] sa ka qenë në vitin 2021 shitjet janë rritur në 228 [l/b/d].

Uji i pa-faturuar, ka shënuar progres të kënaqshëm tek KRU Mitrovica; nga 55% sa ishte vlera e UPF gjatë vitit 2021 është ulur në 51% gjatë periudhës 2022 H1. Ky përmirësim ka ndodhë kryesisht si rezultat i optimalizimit të prodhimit të ujit krahasuar me vitin paraprak dhe rritjes volumetrike të faturimit për konsumatorë në ditë gjatë periudhës 2022 H1.

Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës, gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore 2022 H1 ka shënuar progres për 1% në raport me vitin paraprak por ende është larg vlerës së dëshiruar prej 100%. Numri i konsumatorëve shtëpiak që nuk posedojnë ujëmatës tek kjo kompani është rreth 4,000 konsumatorë. KRU Mitrovica duhet të bëjë progres të ndjeshëm në këtë aspekt, pasi faturimi sipas matjes është nga standardet kryesore të shërbimit.

Shkalla e arkëtimit gjatë periudhës 2022 H1 krahasuar me vitin 2021 ka shënuar rënie për 5%. Është brengosëse përqindja kaq e ulët e arkëtimit tek KRU Mitrovica (69%). Kjo ka ndodhur kryesisht si rezultat i rritjes volumetrike të ujit të faturuar për konsumatorë duke ndikuar pastaj edhe në rritjen e shitjeve në euro.

Norma e mbulimit të punës ka pësuar regres nga 1.08 sa ishte në vitin 2021 në 0.86 në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022. Ky përkeqësim ka ndodhur si rezultat i zvogëlimit të hyrave tjera themelore dhe mos pranimit të subvencionit për mbulim të shpenzimeve operative nga Qeveria e Kosovës për ujin që furnizohet në pjesën veriore të Mitrovicës. Arsye tjetër është edhe rritja e shpenzimeve operative për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura.

Kostot totale për m³ të ujit të prodhuar kanë shënuar rritje nga 0.11€/m³ sa ishte në vitin 2021 në 0.12 €/m³ gjatë periudhës 2022 H1, rezultat i të cilës ishte rritja e shpenzimeve operative për shërbimet e ujit.

Efikasiteti i stafit ka treguar përmirësim të lehtë gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve, edhe përkundër rritjes së numrit të punëtorëve.

Për sa i përket ankesave të konsumatorëve, duket që raportimi për këtë tregues nuk është i saktë dhe duhet të konfirmohet.

Arritjet:

- Ka trend pozitiv tek mbulimi i konsumatorëve me ujëmatës nga viti në vit. Gjatë periudhës 2022 H1 në raport me vitin paraprak 2021 janë instaluar mbi 2 mijë ujëmatës të rinj.
- Uji i pa faturuar gjatë kësaj periudhe te analizës ka shënuar trend pozitiv për 4%. KRU Mitrovica inkurajohet të vazhdojë të punojë në drejtim të optimalizimit të prodhimit të ujit.
- Edhe te treguesi i efikasitetit të stafit është shënuar trend pozitiv krahasuar me vitin paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve me mbi 2,600 konsumatorë të rinj. Ky tregues ende është i lartë krahasuar me mesataren e sektorit në Kosovë dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Sfidat:

- Edhe përkundër progresit në disa tregues, gjendja e UPF është ende e lartë. Kompania duhet të angazhohet edhe më shumë në zvogëlimin e humbjeve fizike dhe administrative, veçanërisht mbulimin e të gjithë konsumatorëve me ujëmatës të rinj dhe funksional.
- Përmirësimi i shkallës së arkëtimit tek konsumatorët shtëpiak.
- Përmirësimi i normës së mbulimit te punës duke përmirësuar performancën financiare me zvogëlimin e kostove totale operative si dhe përmirësimin e mëtejshëm të shkallës së arkëtimit.
- Përmirësimi edhe me tej i efikasitetit të stafit përmes rritjes së mbulueshmërisë të zonës së shërbimit me shërbime të ujit.

KRU Gjakova sh.a.

Në tabelën 6. është paraqitur performanca e KRU Gjakova sh.a. për disa prej treguesve reprezentativ.

Tabela 6. Performanca relative e KRU 'Gjakova', sh.a.

Treguesit	2021	2022 H1
Prodhimi i ujit (l/b/d)	253	247
Shitja e ujit (l/b/d)	146	129
Uji i pa-faturuar (%)	42	48
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	100	100
Shkalla e arkëtimit (%)	103	103
Norma e mbulimit të punës	1.33	1.21
Kostoja totale për njësi (€/m ³ /prodhuar)	0.22	0.24
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.70	6.54
Ankesat për ('000 kons)	7.8	3.5

Prodhimi i ujit [l/b/d] tek KRU Gjakova kap vlerën prej 236 l/b/d gjatë periudhës 2022 H1, e cila vlerë nëse krahasohet me vitin paraprak 2021 ka shënuar një rënie të vogël. Mirëpo fakti se vetëm 129 [l/b/d] kanë arritur t'u faturohen (shiten) konsumatorëve lë vend për përmirësim.

Për sa i përket shitjes së ujit (faturimit volumetrik të ujit) për konsumatorë për ditë ka një përkeqësim. KRU Gjakova duhet të analizojë dhe identifikojë arsyet pse ka ardhur te ulja e shitjeve dhe të adresojë me kohë gjetjet.

Uji i pa-faturuar te KRU Gjakova ka shënuar përkeqësim, nga 42% sa ishte përqindja gjatë vitit 2021 është rritur në 48% gjatë periudhës gjashtëmujore 2022 H1. KRU Gjakova duhet të fokusohet për të treguar përmirësim edhe tek ky tregues i performancës në periudhën e mbetur të vitit 2022.

KRU Gjakova ka arritur pothuajse të gjithë konsumatorët e vet ti faturoj sipas leximit të ujëmatësve. Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës tek kjo kompani gjatë periudhës 2022 H1 arrin normën prej 100%. Sipas të dhënave të raportuara vetëm 13 konsumatorë shtëpiak kanë mbetur pa u pajisur me ujëmatës.

Tek KRU Gjakova shkalla e arkëtimit gjatë periudhës 2022 H1 krahasuar me vitin 2021 ka mbetur e njëjtë dhe arrin përqindjen prej 103%, kjo si rezultat i arkëtimit edhe të borxheve të vjetra.

Norma e mbulimit të punës ka treguar përkeqësim prej 9% në krahasim me vitin paraprak nga 1.33 sa ishte në vitin 2021 në 1.21 gjatë periudhës 2022 H1, pjesërisht si rezultat i zvogëlimit volumetrik të faturimit. Kjo do të thotë se kompania këtë vit përkundër nivelit të njëjtë të shkallës se arkëtimit do të ketë të hyra më të ulëta, edhe pse ende nuk rrezikohet qëndrueshmëria financiare e saj.

Gjatë periudhës 2022 H1 kostoja e përgjithshme për m³ të ujit të prodhuar tek KRU Gjakova kanë qenë me e larta në raport me kompanitë e tjera, duke shënuar rritje për 12%; nga 0.22

€/m³ sa ishte në 2021 në 0.24 €/m³ në 2022 H1. Kjo është si rezultat i zvogëlimit të ujit të prodhuar dhe rritje të shpenzimeve operative për shërbimet këto shërbime.

Efikasiteti i stafit ka treguar trend pozitiv duke rënë nga 6.70 në 6.54 për periudhën gjashtëmujore të vitit 2022, rezultat i këtij trendi pozitiv ishte rritja e numrit të konsumatorëve përderisa numri i punëtorëve është mbajtur në nivel te njëjtë. Megjithatë, norma aktuale prej afër 6.54 punëtorë për 1,000 konsumatorë mbetet ende në nivelin më të lartë në raport me kompanitë tjera në Kosovës.

Arritjet:

- Zvogëlimi i ujit të prodhuar për banorë në ditë. KRU Gjakova duhet të vazhdojë me optimalizim të mëtejshëm të ujit të prodhuar.
- Pajisja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës pothuajse është e plotë, kjo i mundëson kompanisë që të ketë një faturim më të saktë dhe më të drejtë si dhe të ketë kontroll më të madhe sa i përket humbjeve komerciale të ujit.
- Norma e arkëtimit të hyrave nuk ka pësuar ndonjë ndryshim krahasuar me vitin 2021, pra ka mbet në nivelin e njëjtë prej 103%,

Sfidat:

- Zvogëlimi i UPF duke ndërmarrë masa dhe aktivitete më dinamike në drejtim të identifikimit të kyçjeve ilegale dhe përmes implementimit të masave për menaxhim të presionit.
- Zvogëlimi i kostove të shërbimit, me një theks në reduktimin e kostove për njësi të ujit të prodhuar,
- Efikasiteti i stafit edhe pse ka treguar përmirësim në 2022H1, megjithatë vazhdon të jetë kompania me numrin më të madh të punëtorëve në raport me konsumatorët e saj.
- Përmirësimi i efikasitetit të stafit, duke rritur bazën e konsumatorëve dhe zvogëluar numrin e punëtorëve.

KRU Bifurkacioni sh.a.

Në tabelën 7 është paraqitur performanca e KRU Bifurkacioni sh.a. për disa prej treguesve më reprezentativ.

Tabela 7. Performanca relative e KRU 'Bifurkacioni', sh.a.

Treguesit	2021	2022 H1
Prodhimi i ujit (l/b/d)	182	182
Shitja e ujit (l/b/d)	78	82
Uji i pa-faturuar (%)	57	55
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	100	100
Shkalla e arkëtimit (%)	80	78
Norma e mbulimit të punës	1.17	1.24
Kostoja totale për njësi (€/m ³ /prodhuar)	0.16	0.15
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.72	5.49
Ankesat për ('000 kons)	5.7	3.1

Prodhimi i ujit [l/b/d] tek KRU Bifurkacioni ka mbetur i njëjtë me vitin paraprak, me 182 [l/b/d] gjatë periudhës 2022 H1, përderisa faturimi volumetrik i ujit është rritur paksa, megjithatë mbetet tejet i ulët dhe as gjysma e ujit të prodhuar nuk faturohet (shitet). Uji i shitur ka pasur rritje të vogël nga 78 [l/b/d] në vitin 2021 është rritur në 82 [l/b/d] në 2022 H1.

Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës në këtë kompani është i plotë, që do të thotë se të gjithë konsumatorët shtëpiak gjatë periudhës 2022 H1, sipas raportimit të KRU Bifurkacioni, faturohen sipas leximit me ujëmatësit.

Uji i pa faturuar tek KRU Bifurkacioni ka shënuar progres për 2% gjatë periudhës së analizës gjashtëmujore 2022 H1 në raport me vitin paraprak 2021. Ky progres i atribuohet kryesisht rritjes volumetrike të ujit të faturuar. KRU Bifurkacioni inkurajohet të ndër marrë masa të mëtejme për optimalizim të prodhimit të ujit dhe rritje të ujit të faturuar.

Shkalla e arkëtimit në periudhën 2022 H1 është përkeqësuar për 2% krahasuar me vitin 2021 dhe atë kryesisht për shkak të rritjes volumetrike të ujit të faturuar.

Norma e mbulimit të punës për dallim nga kompanitë e tjera ka shënuar përmirësim në krahasim me vitin paraprak nga 1.17 vitin 2021 në 1.24 në vitin 2022 H1, e cila ka ndodhur si pasojë e rritjes së hyrave të arkëtuara, e veçanërisht zvogëlimit të shpenzimeve operative të përgjithshme për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura.

Në periudhën 2022 H1 kostoja totale për m³ të ujit të prodhuar ka shënuar përmirësim nga 0.16 (€/m³) sa ka qenë në vitin 2021, është ulur në 0.15 (€/m³) në vitin 2022 H1, rezultat i të cilës është zvogëlimi i shpenzimeve për shërbimet e ujit dhe mbajtjes në nivel të njëjtë me vitin paraprak të ujit të prodhuar në m³.

Edhe tek treguesi efikasiteti i stafit është shënuar progres, nga 5.72 sa ishte në vitin 2021 në 5.49 në 2022 H1, rezultat i të cilës ishte rritja e numrit të konsumatorëve, përderisa numri i punëtorëve nuk ka lëvizur fare.

Për sa i përket ankesave të konsumatorëve, ato kanë mbetur afërsisht në nivel të njëjtë me periudhën e vitit 2021.

Arritjet:

- Zvogëlimi i UPF nga 57% sa ishte gjatë vitit 2021 në 55% për periudhën 2022 H1.
- Pajisja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës është në nivel prej 100%.
- Norma e mbulimit të punës ka treguar përmirësim, rezultat i të cilës ishte zvogëlimi i shpenzimeve totale dhe rritja e të hyrave të arkëtuara në vlerë monetare.
- Kosto totale për njësi e uji të prodhuar ka treguar trend pozitiv me një rënie prej 4%.
- Efikasiteti i stafit është përmirësuar si rezultat i shtimit të numrit të konsumatorëve me mbi 1,400 konsumatorë të rinj.

Sfidat:

- Zvogëlimin e ujit të pa faturuar, përmes aktiviteteve në kontrollimin e kyçjeve ilegale, leximit të saktë të ujëmatësve, vazhdimin të rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit.
- Përmirësimin edhe me tej të efikasitetit të stafit duke rritur bazën e konsumatorëve dhe zvogëluar numrin e punëtorëve. Niveli aktual prej 5.49 është mbi mesataren e sektorit në Kosovë.

KRU Hidromorava sh.a.

Në tabelën 8. është paraqitur performanca e KRU Hidromorava sh.a. për disa prej treguesve më reprezentativ.

Tabela 8. Performanca relative e KRU ‘Hidromorava’, sh.a.

Treguesit	2021	2022 H1
Prodhimi i ujit (l/b/d)	185	177
Shitja e ujit (l/b/d)	96	93
Uji i pa-faturuar (%)	48	48
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	99	99.5
Shkalla e arkëtimit (%)	92	83
Norma e mbulimit të punës	1.18	1.07
Kostoja totale për njësi (€/m ³ /prodhuar)	0.21	0.21
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	4.44	4.51
Ankesat për ('000 kons)	17.8	9

Prodhimi i ujit [l/b/d] tek KRU Hidromorava ka shënuar rënie nga 185 [l/b/d] sa ka qenë në 2021 në 177 [l/b/d] në 2022 H1. Prodhimi i ujit është më i ulëti nga të gjitha KRU-të në Kosovë.

Me brengosës është fakti që edhe faturimi volumetrik i ujit për banorë në ditë është zvogëluar; nga 96 [l/b/d] sa ka qenë në vitin 2021 është zvogëluar në 93 [l/b/d].

Tek KRU Hidromorava UPF gjatë periudhës 2022 H1 ka mbet në nivel të njëjtë - 48% në raport me vitin paraprak 2021. Marrë parasysh resurset e kufizuara të burimeve të ujit në këtë regjion, KRU Hidromorava duhet të jetë më e angazhuar edhe më tej UPF.

Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës në 2022 H1 qëndron në nivelin afërsisht të njëjtë me vitin paraprak prej 99%. KRU Hidromorava duhet të punojë më shumë që të gjithë konsumatorët e vet ti faturojë sipas leximit, që është standard i shërbimit.

Gjatë periudhës 2022 H1 shkalla e arkëtimit ka rënë prej 92% në 83%; ky regres i atribuohet më së shumti mos arkëtimit të hyrave prej konsumatorëve institucional, arkëtimi tek kjo kategori e konsumatorëve ka rënë nga 100% në 73%.

Përkundër rënies së shpenzimeve operative, rënia e lartë e shkallës së arkëtimit pa dyshim që do të ndikoj tek treguesi i normës së mbulimit të punës, që ka rënë nga 1.18 (në vitin 2021) në 1.07 në vitin 2022 (ulje prej 9%). KRU Hidromorava edhe pse kishte regres në këtë tregues prapë ishte në gjendje të mbulojë shpenzimet e përgjithshme operative.

Në periudhën 2022 H1 krahasuar me vitin 2021 shpenzimet operative për m³ të ujit të prodhuar nuk kanë pasur ndonjë ndryshim kanë mbetur në nivelin e njëjtë prej 0.21 Euro/m³.

Efikasiteti i stafit ka pasur një përkeqësim të vogël nga 4.44 në vitin 2021 është rritur në 4.51 në vitin 2022 H1.

Për sa i përket ankesave të konsumatorëve, bazuar në raportimin nga KRU Hidromorava, ato janë përgjysmuar.

Arritjet:

- Është vërejtur një ulje e lehtë e prodhimit të ujit krahasuar me vitin paraprak. Tek treguesit tjerë KRU Hidromorava ka mbetur në nivelin e vitit paraprak ose ka shënuar rënie.

Sfidat:

- Menaxhimi i mungesës së resurseve ujore, kryesisht në periudhat me thatësi, kriza këto të cilat po shpeshtohen me kalimin e viteve.
- Zvogëlimi i ujit të pa-faturuar, duke marrë parasysh resurset e kufizuara, KRU Hidromorava duhet të jetë më e fokusuar në drejtim të identifikimit të kyçjeve ilegale dhe rehabilitimit të rrjetit shpërndarës.
- Rritja e arkëtimit, me theks të veçantë fokusi tek kategoria e konsumatorëve institucional.
- Përmirësimi dhe ngritja e normës së mbulimit të punës, përmes zvogëlimit të shpenzimeve dhe rritjes së arkëtimit.
- Përmirësimi i efikasitet të stafit, duke rritur efikasitetin dhe bazën e konsumatorëve në zonën e shërbimit.

4. KONKLUSIONE TË PËRGJITHËSHME

Në përgjithësi KRU-të edhe në këtë gjashtëmuor (2022 H1), kanë treguar efikasitet jo të kënaqshme operative dhe financiare për arsyt vijuese:

- Prodhimi i ujit në disa KRU është tejet i lartë, kurse më pakë gjysma e këtij vëllimi faturohet ose sjellë të ardhura për KRU-të.
- Përqindja e lartë e UPF tek të gjitha KRU-të vazhdon të paraqes pengesë në furnizimin e vazhdueshëm me ujë si dhe mungesë të qëndrueshmërisë financiare të KRU-ve.
- Efikasiteti financiar vazhdon të jetë një prej sfidave të mëdha KRU-ve, shërbimet janë me kosto relativisht të lartë operative, mungesë të efikasitetit të arkëtimit të hyrave dhe me efikasitet të dobët të personelit.

SHTOJCA

Në tabelën në vijim janë përmbledhur të dhënat për disa treguesish operativ.

	Periudha/ viti	Prodhimi i ujit (m ³)	Uji i faturuar (m ³)	Uji i pa faturuar (m ³)
PR	2021	55,175,048	23,161,373	32,013,675
	2021 H1	27,205,447	11,252,839	15,952,608
	2022 H1	27,205,515	11,865,551	15,339,964
HJ	2021	16,928,504	7,718,785	9,209,719
	2021 H1	8,056,759	3,646,163	4,410,596
	2022 H1	7,961,765	3,669,255	4,292,510
HID	2021	24,842,768	10,333,538	14,509,230
	2021 H1	12,359,804	4,909,169	7,450,635
	2022 H1	12,298,918	5,232,539	7,066,379
MIT	2021	27,457,562	12,301,466	15,156,096
	2021 H1	13,319,522	5,917,386	7,402,136
	2022 H1	13,672,906	6,697,761	6,975,145
GJA	2021	15,910,071	9,167,666	6,742,405
	2021 H1	7,402,365	4,366,647	3,035,718
	2022 H1	7,787,571	4,077,807	3,709,764
BIF	2021	8,258,735	3,562,927	4,695,808
	2021 H1	4,227,517	1,728,625	2,498,891
	2022 H1	4,132,048	1,871,499	2,260,549
HIM	2021	7,801,252	4,038,271	3,762,981
	2021 H1	3,633,418	1,890,284	1,743,134
	2022 H1	3,739,485	1,951,917	1,787,568
Sektor	2021	156,373,940	70,284,026	86,089,914
	2021 H1	76,204,832	33,711,113	42,493,718
	2022 H1	76,798,208	35,366,329	41,431,879

Në tabelën vijuese janë përmbledhur treguesit më kryesor financiar.

	Periudha/ viti	Faturimi (Euro)	Arkëtimi (Euro)	Te hyrat tjera operative themelore (Euro)	Subvencioni	Shpenzimet operative totale per Uj&Ujera t[ndotua (Euro)	Shpenzimet operative për Ujë (Euro)
PR	2021	14,312,132	13,074,944	77,015	-	10,254,011	9,842,212
	2021 H1	7,048,788	6,291,035	33,673	-	5,035,994	4,895,223
	2022 H1	7,584,486	6,225,915	36,909	-	5,199,322	5,057,014
HJ	2021	5,067,106	5,063,171	52,881	-	3,872,999	3,063,889
	2021 H1	2,320,727	2,331,639	-	-	1,933,965	1,519,653
	2022 H1	2,475,422	2,283,571	23,179	-	1,960,929	1,322,165
HID	2021	3,961,528	5,090,905	60,785	-	2,903,742	2,606,115
	2021 H1	1,896,304	1,630,589	25,254	-	1,374,490	1,294,397
	2022 H1	2,035,705	1,589,512	21,171	-	1,526,450	1,402,610
MIT	2021	3,893,840	2,889,570	42,606	691,030	3,363,490	3,040,126
	2021 H1	1,866,704	1,299,594	-	330,000	1,695,788	1,527,471
	2022 H1	2,193,694	1,518,849	19,791	-	1,780,977	1,612,736
GJA	2021	4,662,378	4,817,042	24,640	-	3,642,510	3,425,181
	2021 H1	2,188,433	2,179,329	14,059	-	1,800,168	1,754,096
	2022 H1	2,318,185	2,391,050	10,775	-	1,984,107	1,875,341
BIF	2021	2,160,954	1,721,950	52,884	-	1,517,169	1,282,580
	2021 H1	1,034,731	779,116	8,185	-	789,709	643,060
	2022 H1	1,164,956	911,203	21,353	-	753,157	612,879
HIM	2021	2,250,514	2,069,864	33,657	-	1,784,596	1,638,731
	2021 H1	1,067,437	863,043	11,514	-	872,918	799,076
	2022 H1	1,111,701	919,736	12,962	-	869,128	799,160
Sektori	2021	36,308,453	34,727,445	344,468	691,030	27,338,517	24,898,834
	2021 H1	17,423,123	15,374,345	92,685	330,000	13,503,032	12,432,976
	2022 H1	18,884,149	15,839,836	146,140	-	14,074,070	12,681,905

Në tabelën në vijim janë përmbledhur të dhënat për numrin e konsumatorëve dhe numrin e punëtorëve të punësuar nëpër KRU.

	Periudha/ viti	Numri i konsumatoreve	Numri i punëtorëve
PR	2021	153,509	556
	2021 H1	151,204	557
	2022 H1	158,372	543
HJ	2021	54,104	332
	2021 H1	53,399	331
	2022 H1	55,426	325
HID	2021	53,205	230
	2021 H1	52,351	227
	2022 H1	55,919	230
MIT	2021	43,897	260
	2021 H1	42,758	260
	2022 H1	46,549	272
GJA	2021	43,737	293
	2021 H1	42,379	285
	2022 H1	44,675	292
BIF	2021	33,551	192
	2021 H1	32,431	200
	2022 H1	34,973	192
HIM	2021	34,703	154
	2021 H1	34,057	157
	2022 H1	35,264	159
Spektori	2021	416,706	2,017
	2021 H1	408,579	2,017
	2022 H1	431,178	2,013